



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 630/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

### V E N D I M

I. Ri/akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Dizajn Skene dhe Kostumografi, BA, 240 ECTS, (me specializime:Dizajn Skene; Kostumografi ), (maksimum 7 studentë për vit akademik);
- Dizajn Skene dhe Kostumografi, MA, 60 ECTS, (me specializime: Dizajn Skene; Dizajn Kostumesh ), (maksimum 6 studentë për vit akademik);
- Regji Filmi dhe Televizioni, BA, 240 ECTS, (me specializime: Regji Filmi dhe Televizioni), (maksimum 8 studentë për vit akademik);
- Regji Teatri, BA, 240 ECTS, (me specializime: Regji Teatri), (maksimum 6 studentë për vit akademik);
- Regji Teatri, MA, 60 ECTS, (me specializime: Teatri Modern; Teatri Performativ; Teatri Eksperimental), (maksimum 8 studentë për vit akademik);
- Aktrim, BA, 240 ECTS, (me specializim: Aktrim), (maksimum 12 studentë për vit akademik);
- Aktrim, MA, 60 ECTS, (me specializim: Film; Teatër; Performancë), (maksimum 12 studentë për vit akademik);
- Dramaturgji, BA, 240 ECTS, (me specializim: Dramaturgji), (maksimum 6 studentë për vit akademik);
- Dramaturgji, MA, 60 ECTS, (me specializim: Dramaturgji; Skenar) (maksimum 6 studentë për vit akademik).

II. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Artet Vizuele BA, 240 ECTS, (me specializime: Pikturë; Skulpturë; Grafikë; Arti konceptual dhe Mediat e Reja), (maksimum 50 studentë për vit akademik);
- Artet Aplikative, BA, 240 ECTS, (me specializim në: Dizajn Grafik), (maksimum 12 studentë për vit akademik);
- Artet Vizuele, MA, 60 ECTS, (me specializime: Pikturë; Skulpturë; Grafikë; Arti Konceptual dhe Mediat e Reja, Moduli A: Arti Bashkëkohor; Moduli B: Arti Modern), (maksimum 50 studentë për vit akademik);
- Artet Aplikative, MA, 60 ECTS, (me specializime: Mediat Aplikative me Promocion; Mediat Informative me Komunikim), (maksimum 12 studentë për vit akademik);
- Bachelor i Muzikës, BA, 240 ECTS, (me specializime: Pedagogji e përgjithshme Muzikore; Kompozim), (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Bachelor i Muzikës në Performim, BA, 240 ECTS, (me specializime: Piano; Instrumentet me Harqe dhe Tela; Instrumentet Frymore; Solo Këndimi; Dirigjimi), (maksimum 50 studentë për vit akademik);
- Master i Muzikës, MA, 60 ECTS, (me specializim: Pedagogji e Përgjithshme muzikore; Kompozim), (maksimum 15 studentë për vit akademik);
- Master i Muzikës në Performim, MA, 60 ECTS, (me specializim: Piano; Instrumentet me Harqe dhe Tela; Instrumentet Frymore; Solo Këndimi; Dirigjimi), (maksimum 25 studentë për vit akademik).

III. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

IV. Obligohet Fakultetit i Arteve i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

V. Obligohet Fakulteti i Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

## **A r s y e t i m i**

Fakulteti i Arteve i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Dizajn Skene dhe Kostumografi	BA	240	Burim Gora, Vlora Kosumi-Ismajli, Emin Halili
2	Dizajn Skene dhe Kostumografi	MA	60	Agnesa Muharremi, Miradije Ramiqi, Lyra Binishi-Zajmi
3	Regji Filmi dhe Televizioni	BA	240	Jeton Ahmetaj, Ismet Sijarina, Sylejman Kllokoqi
4	Regji Teatri,	BA	240	Elmaze Nura, Mentor Zymberaj, Drita Begolli
5	Regji Teatri	MA	60	Bekim Lumi, Fadil Hysaj, Trimor Dhomi
6	Aktrim	BA	240	Arbnesha Nixha, Astrit Kabashi, Shkumbin Istrefi
7	Aktrim	MA	60	Agnes Nokshiqi, Ilire Celaj, Alma Bektashi
8	Dramaturgji	BA	240	Zymer Kelmendi, Haki Mulliqi, Shyqri Galica
9	Dramaturgji	MA	60	Besim Rexhaj, Haqif Mulliqi, Ekrem Xani
10	Artet Vizuele	BA	240	Valbona Krasniqi-Rexhepi, Eshref Qahili, Valdeta Vuçiterna-Veliu
11	Artet Aplikative	BA	240	Menduh Nushi, Guri Çavdarbasha, Mirsad Lushtaku
12	Artet Vizuele, MA	MA	60	Mehmet Behluli, Ismet Jonuzi, Zake Prelvukaj
13	Artet Aplikative	MA	60	Faik Krasniqi, Muhamet Ahmeti, Visar Mulliqi
14	Bachelor i Muzikës	BA	240	Valton Beqiri, Zana Berisha-Basha, Kreshnik Alickaj
15	Bachelor i Muzikës në Performim	BA	240	Lejla Pula, Antonio Gashi, Venera Kajtazi
16	Master i Muzikës	MA	60	Besa Luzha, Dafina Zeqiri, Astrit Mustafa
17	Master i Muzikës në Performim	MA	60	Lule Elezi, Merita Juniku-Qerkezi, Arianit Shehu

AKA ka organizuar vizitën në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” më 20.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Teresa Brayshaw, Steve Purcell, Andrew Fryer.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe pas duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë